



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 681/2 Prot.

Tiranë, më 02.11.2020

**V E N D I M**

Nr.140, datë 02.11.2020

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të informacionit/kërkesës nr. 681 prot., datë 14.9.2020, të nëpunësit civil \*\*\*\*\* , në lidhje me disa pretendime për parregullsi të kryera/lejuara në procedurën e transferimit të tij të përkohshëm.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e pretendimeve të ngritura nga nëpunësi \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 681 prot., datë 14.9.2020, nëpunësi doganor \*\*\*\*\* , ka parashtruar pretendimin se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka kryer veprimet e nevojshme administrative për kthimin e tij në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Produkteve Energjetike”, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), ku ai ka emërimin e përhershëm në shërbimin civil, pas kalimit të afatit ligjor të transferimit të përkohshëm, fillimisht në pozicionin “Përgjegjës Turni”, Zyra e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Tre – Urat (Përmet) e më pas në pozicionin “Specialist GFI, Sektori i Produkteve Energjetike”, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nga hetimi administrativ i këtij rasti konstatohet që, pas ristrukturimit të kryer në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me propozim të Komisionit të Ristrukturimit të DPD, me aktin nr. 7792/154, datë 1.11.2018, ka miratuar transferimin e përhershëm të nëpunësit \*\*\*\*\* , në pozicionin “Specialist në Sektorin e Produkteve Energjetike”, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Për veprimet e kryera në këtë rast, konstatohet se janë respektuar rregullat që parashikon ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe dispozitat e posaçme të legjislacionit doganor (pika 8, e nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht që në administrimin e shërbimit doganor, krahas dispozitave të posaçme të Kodit Doganor zbatohen edhe dispozitat e legjislacionit të shërbimit civil.

Pasi ka marrë emërimin në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Produkteve Energjetike*”, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, rezulton se për interes të institucionit, me aktin nr. 3925 prot., datë 19.2.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëpunësi \*\*\*\*\* është transferuar përkohësisht, në pozicionin “*Përgjegjës Turni*”, Zyra e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Tre – Urat (Përmet), pozicion ky i të njëjtës kategori me pozicionin ku kishte emërimin e përhershëm.

Ndërkohë, pas tre muajsh, ende pa u plotësuar afati 6-mujor i transferimit të parë, për kërkuesin ka dalë një urdhër i dytë transferimi, e konkretisht urdhri nr. 9233 prot., datë 21.5.2020, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ku përsëri për nevoja të institucionit ai është transferuar për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj, në detyrën “*Specialist GFI, Sektori i Produkteve Energjetike*”, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (ku vazhdon të punojë, aktualisht).

Rezulton se, nëpërmjet urdhrorit të dytë, kërkuesi është transferuar në sektorin ku ka emërimin e përhershëm, por pozicioni “*Specialist GFI*”, ku ai kryen detyrat aktualisht është i kategorisë C2, ndërsa pozicioni “*Specialist*”, ku ai ka emërimin e rregullt i përket kategorisë C1, ndërkohë që në aktin e transferimit është specifikuar që pagesa, pavarësisht kategorisë së pozicionit të punës, të bëhet sipas kategorisë C1.

Nga dokumentet e administruara rezulton se, pas kalimit të një periudhe 6-mujore, (duke e llogaritur atë që nga fillimi i transferimit të parë), nëpunësi \*\*\*\*\* i është drejtuar me shkresë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DPD, duke kërkuar kthimin në pozicionin e punës ku ai ka emërimin e rregullt. Në përmbajtjen e kërkesës ngrihet pretendimi se afati maksimal i transferimit të përkohshëm deri në 6 muaj, ka kaluar, e për këtë arsye duhet të kthehet në vendin e punës si “*Specialist në Sektorin e Produkteve Energjetike*”, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), kategoria C1, kategoria e pagës III-b, (kërkesa nr. 15454 prot., dt. 18.8.2020).

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pasi ka marrë në shqyrtim këtë kërkesë, me shkresën nr. 15454/1 prot., datë 3.9.2020, “*Kthim përgjigje*”, ka bërë me dije kërkuesin se në bazë të të dhënave të punësimit të regjistruara pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, në lidhje me kërkesën e paraqitur do të njoftohet në vijim.

Duke bërë vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të transferimit të përkohshëm, konstatohet që për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, në legjislacionin specifik të

tij (pika 3 e nenit 13, të Kodit Doganor), janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve e kohëzgjatjes së tyre, ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, në pikën 7, të nenit 15, të këtij kodi, në shkronjën “a”, përcaktohet: *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

*i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*

*ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;*

*iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës”.*

Nga këqyrja e dispozitës së mësipërme, shihet se në shkronjën “i”, të nenit 15, pika 7/a, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për shkak të veçorive që karakterizojnë veprimtarinë doganore, është hequr kufizimi i dispozitës së ngjashme të pikës 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës mund të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 (gjashtë) muaj (me/ose pa ndërprerje) për nevoja të punës, por kjo lejohet vetëm një herë gjatë dy viteve. Përkundrazi, sipas kësaj dispozite të Kodit Doganor, një nëpunës doganor mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa herë vlerësohet një nevojë e tillë, pa patur ndonjë kufizim.

Në rastin në shqyrtim, duke analizuar pretendimin e kërkuesit se tashmë ka kaluar afati 6 mujor nëse mblidhen kohet e dy transferimeve dhe se ai duhet të kthehet në pozicionin e tij të punës, arsyetojmë se në këtë rast kemi të bëjmë me dy transferime të njëpasnjëshme të veçanta.

Transferimi i pare i përkohshëm, urdhëruar me me aktin nr. 3925 prot., datë 19.2.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për kalimin në pozicionin “Përgjegjës Turni”, Zyra e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Tre – Urat (Përmet) ka përfunduar pa u përmbushur afati maksimal 6 mujor, gjë e cila lejohet nga ligji i cili përcakton se transferimi i përkohshëm mund të zgjasë deri në 6 muaj. Me daljen e aktit nr. 9233 prot., datë 21.5.2020, me të cilin është urdhëruar transferimi i dytë për kërkuesin, në detyrën “Specialist GFI, Sektori i Produkteve Energjetike”, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriori), pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (ku vazhdon të punojë, aktualisht), kemi të bëjmë me një transferim të dytë i cili edhe pse është dhënë menjëherë pas një transferimi të përkohshëm të mëparshëm, është i lejueshëm nga dispozita e nenit 15, të Kodit Doganor, cituar më sipër.

Siç është përmendur dhe më lart, Kodi Doganor, nuk e ka kufizimin që përmban dispozita e nenit 48/1 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, prandaj Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, si autoriteti i njohur nga ligji, ka të drejtë të transferojë, në mënyrë të përkohshme, për interes të institucionit, pa kufizim.

Kompetenca e mësipërme për Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, parashikohet në pikën 17, kreu V, “Transferimi i përkohshëm”, të vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar, dalë në zbatim të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga gjithë sa më sipër, në analizë të fakteve dhe të akteve ligjore, arrihet në përfundimin se pretendimi i punonjësit \*\*\*\*\*, se duhet të kthehet në pozicionin e punës ku ka emërimin e përhershëm pasi nga mbledhja e kohës së dy transferimeve, tejkalohet afati 6 mujor, është i pambështetur në ligj.

Është në vlerësimin e drejtuesit të institucionit, që të urdhërojë transferime të përkohëshme për interes të institucionit, gjithmonë duke mbajtur parasysh parimet e barazisë, mosdiskriminimit, etj, përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe nenit 17, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 681 prot., datë 14.9.2020, të nëpunësit \*\*\*\*\* , pasi nuk janë evidentuar parregullsi të kryera apo të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedurës së transferimit të përkohshëm.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, si dhe kërkuesi \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**